

ASIME FERAJ

SILVANA KOÇO

**TË DHËNA STATISTIKORE PËR VEPRËN E FATOS ARAPIT
SIPAS PROGRAMIT SIMPLE CONCORDANCE PROGRAM**

Ne e kemi parë gjerë dendurinë e përdorimit të Fatos Arapit, ndaj si objekt të këtij studimi kemi bërë analiza statistikore të hollësishme në përmbledhjen poetike **“Eklipsi i ëndrrës”** dhe romanin **“Deti në mes”**, në të cilat kemi nxjerrë të dhëna mbi frekuencën e njësive leksikore, frekuencën e grafemave dhe frekuencën e gjatësisë së fjalëve. Të dhënat janë pasqyruar me tabela dhe grafikët përkatës, por edhe grafikëkrahësues.

Për arritjen e përfundimeve sa më të sakta në lidhje me fondin leksikor të veprës së Fatos Arapit, kemi shfrytëzuar statistika të nxjerra përmes programit kompjuterik SCP. Statistikat janë nxjerrë një për secilin prej llojeve letrare, në poezi dhe prozë, në veprat e sipërpërmendura. Kjo na ka mundësuar përqasjet në përputhje me llojet e ndryshme letrare, por edhe në përputhje me zhvillimet në rrjedhën kohore, duke qenë se autori ka lëvruar poezinë dhe prozën që në fillimet e krijimtarisë së tij, ka lëvruar romanin në një periudhë të mëvonshme.

Fjalë me denduri të lartë përdorimi dalin rreth 6.9% e leksikut. Shumë nga këto leksema janë *fjalë-çelës*, *figura-çelës* apo edhe *tema-çelës*. Këto leksema i gjejmë jo vetëm në një vepër, as vetëm në prozën e Fatos Arapit, por në gjithë krijimtarinë e tij, si në prozë edhe në poezi, pra jo vetëm në rrafshin e tekstit, por edhe të metatekstit, me anë të të cilave organizohet i gjithë produkti letrar të Fatos Arapit. Shumë prej këtyre leksemave kanë fituar vlerën e simbolit, duke e zgjeruar aftësinë e tyre shënjtuese dhe ndikojnë në sistemin e figurshmërisë.

Të dhënat statistikore të nxjerra prej veprës së Fatos Arapit do të mund të shërbejnë edhe për studime të tjera, si për veprën e Fatos Arapit e

cila është një det i pafund me lëndë gjuhësore ashtu edhe për studime përfaqëse për gjuhën e autorëve të ndryshëm, parë nga interesa dhe këndvështrime të ndryshme gjuhësore.

Fjalë çelës: *dhënat statistikore, frekuencë, njësi leksikore, grafemë, Simple Concordance Program*

I. Frekuenca e fjalëve

1. “Eklipsi i ëndrrës”

Vepra poetike “Eklipsi i ëndrrës” përfshin gjithsej 4454 njësi leksikore të cilat dalin në 16997 raste përdorimi, duke arritur kështu një denduri mesatare përdorimi (DMP) 3.8 herë. Bazuar në dendurinë e përdorimit kemi përcaktuar një nënndarje të leksikut në tri grupe (ngr):

- 1) fjalë me denduri të ulët përdorimi,
- 2) fjalë me denduri të mesme përdorimi,
- 3) fjalë me denduri të lartë përdorimi.

Kufiri më i ulët ndarës K_n është: $DMP \times 2 / 3 \text{ ngr} \Rightarrow 3.8 \times 2 / 3 = 2.53$

Fjalët që përdoren 1 – 3 herë do t’i përfshijmë në grupin e fjalëve me denduri të ulët përdorimi, ato që përdoren 4 - 6 herë në grupin e fjalëve me denduri të mesme përdorimi, ato që përdoren mbi 7 herë përbëjnë grupin e fjalëve me denduri të lartë përdorimi. Në grupin e parë hyjnë 3784 njësi leksikore, ose 84.95 % e fondit leksikor të veprës. Në grupin e dytë bëjnë pjesë 352 njësi leksikore, ose 7.9 % e fondit leksikor. Në grupin e tretë përfshihen 318 njësi leksikore, ose 7.1 % e fondit leksikor poetik.

Me denduri përdorimi të paktën 1herë dalin 2844 fjalë, që përbëjnë 63.85% poetik. Për më tepër mund t’i referohemi tabelës së vjelë nga programi për analizë.


Të dhëna statistikore për veprën e Fatos Arapit sipas programit SCP

“Eklipsi i ëndrrës”, statistika

Word Frequency	Number of Words	Cumulative Vocabulary	Cumulative Word Count	Percentage Vocabulary	Percentage Word Count
1	2844	2844	2844	63.85272	16.73236
2	667	3511	4178	78.82802	24.58081
3	273	3784	4997	84.95734	29.39931
4	161	3945	5641	88.57207	33.18821
5	122	4067	6251	91.31118	36.77708
6	69	4136	6665	92.86035	39.21280
7	43	4179	6966	93.82577	40.98370
8	31	4210	7214	94.52178	42.44278
9	32	4242	7502	95.24023	44.13720
10	24	4266	7742	95.77907	45.54921
11	12	4278	7874	96.04850	46.32582
12	22	4300	8138	96.54243	47.87904
469	1	4452	14876	99.95510	87.52133
988	1	4453	15864	99.97755	93.33412
1133	1	4454	16997	100.00000	100.00000

Frekuenca e fjaleve ne "Eklipsi i endrres"

1-3 here 4-6 here mbi 7 here



Në fjalët me denduri të lartë përdorimi dalin fjalët: *Atdhe, bukur, burrë, dashurive, drita, dritë, duhen, fatet, fatosin, fjalë, fluturojnë, frymë,*

fëmijë, gjer, gjethe, gjëkundi, hedh, ishim, jepni, jetën, lirisë, lot, lumi, madhe, ndezur, ndofta, ndryshe, nevojë, nis, njeh, nënës, syrit, tirana, tokën, trishtimet, tungjatjeta, e tëra, udhë, ëndrrës (7x),
askush, atë, dhembje, diellit, Evropa, fatin, gjakut, humbur, ke, këmbë, kësaj, këtij, lehtë, meje, puthur, qan, rrosh, shoh, Shqipërinë, sot, thotë, tjerë, tragjedia, varri, vete, vlora, vritet, ëndërr, zot, zëra (8x),
ardhur, diellin, drite, hije, ish, Joint, kokë, kurrë, kush, lirë, malli, midis, moj, mëngjes, nata, pranë, përherë, shkel, shpejtojnë, shpirtit, them, Tiranën, tokë, tragjeditë, trishtimi, trupin, udhën, vdesin, vetes, vi, vret, vërtetë (9x),
ato, bërë, dheut, gjithnjë, isha, jetë, kemi, këmbët, këngë, këto, lirinë, lojë, nëna, përtej, rrugë, shkon, tepër, tonë, varr, vjetër, yt, zemër, zoti (10x),
ashtu, buzë, fundit, gjitha, jeta, jetës, natës, njeriu, përse, sheh, sime, vetmia, veç (11x),
ah, andej, dalë, deti, dorën, emër, frikë, gjelbër, kanë, kohë, koka, kështu, mall, natë, përpara, qielli, shpresa, tua, vjen, vlen, çdo (12x),
apo, ata, dikush, ditë, ecën, ishe, kaq, koha, kryet, këtë, pikë, por, poshtë, qiellin, shpirti, i/e vdekur (13x),
dashuri, gjallë, kjo, ky, loti, mi, pas, shpirtin, vdekjes, vëllai, zemrën (14x),
drejt, herë, jote, para, vish (15x),
asnjë, dhimbje, kohës, mes, patjetër, prapë, sikur, tiranës (16x), dashuria, diçka, duart, jo, kishte, shi, sonte, tënd (17x),
kërkon, ndër, pastaj, qiellit, sa, syve (18x),
jemi, liria, mirë, nesër, shpirt, vdekjen (19x)
duar, kam, pak, vetëm (20x),
bardhë, deti, je, time, vdekje(21x), as, di, dorë (22x), atdheu, dielli (23x),
diku, duhet, parë, ty (24x), dera, brenda (25x), gjithë, shumë, vetë (26x),
mund (27x), ju, time, tënde (28x), sy (40x), jam (44x),

Në fjalët me denduri të lartë përdorimi dalin njësi leksikore që përbëjnë bërthamën e “fjalorit aktiv” të autorit, të cilat përbëjnë edhe motivet kryesore të poezisë së Arapit: *Atdheu, Vlora, Evropa, Tirana, Shqipëria, Joni, rrugë, lumë, dhë, dashuri, malli, buzë, fjalë, ëndërr, shpresë, i/e gjelbër, këngë, sy, jetë, fat, lot, varr, vdekje, trishtim, tragjedi, zot, nata, dritë, diell, hije, shi, det, qiell, liri, gjak, tokë, nënë, vëlla, zemër,*

fëmijë, njeriu, vetmi, trup, frymë, shpirt, i/e ndezur, sot dhe nesër, jam, unë duket se thotë autori në këto fjalë kyç të poezisë së tij.

Në grupin e dytë përfshihen përemra, parafjalë, ndajfolje e pjesëza: *ime* (30x), *e mia* (37x), *këtu* (38x), *i/e saj* (43x), *vetëm* (50x), *ty* (63x), *nga* (66x), *nëpër* (70x), *nuk* (77x), *ku* (82x), *mbi* (83x), *unë* (182x), të cilat shërbejnë për organizimin e tekstit poetik.

Fjalë me frekuencë të lartë në këtë gjini dalin 659 njësi leksikore, apo 6.6 % . Në këtë grupim përfshihen njësitë leksikore që përbëjnë bërthamën e “fjalorit aktiv” të autorit, fjalë që, ashtu siç është e pritshme, shënojnë motivet kryesore të poezisë së tij si: *atdheu, njeriu, Joni, dashuria, dhimbje, vdekur tokë, nata, qielli, zemrën, shpresa, lirisë, tragjedia, komunizmit, shpirtit, tiranës,*


2. Romani “Deti në mes”

Në romanin “Deti në mes” janë përdorur 8545 njësi leksikore, të cilat dalin në 40196 raste përdorimi. Në bazë të përlllogaritjes së mësipërme del një denduri mesatare përdorimi (DMP) për njësi leksikore prej 4,7 herësh. Kufiri më i ulët ndarës është: $Kn = 4.7 \times 2/3 = 3,1$. Në grupimin e fjalëve me denduri të ulët përdorimi do të përfshijmë të gjitha njësitë leksikore me një denduri përdorimi prej 1 - 3 herë, duke na dhënë 7163 njësi leksikore, ose 83.8 % e leksikut të veprës; në grupin e fjalëve me denduri mesatare përdorimi përfshihen njësitë leksikore me denduri përdorimi prej 4 - 7 herë, ku dalin 753 njësi leksikore, ose 8.8 % e leksikut; në grupin e fjalëve me denduri të lartë përdorimi përfshihen fjalët me denduri përdorimi mbi 8 herë, duke dalë 529 njësi leksikore, ose 6.1 % e leksikut.

ASIME FERAJ - SILVANA KOÇO

Word Frequency	Number of Words	Cumulative Vocabulary	Cumulative Word Count	Percentage Vocabulary	Percentage Word Count
1	5574	5574	5574	65.23113	13.86705
2	1082	6656	7738	77.89350	19.25067
3	507	7163	9259	83.82680	23.03463
4	303	7466	10471	87.37273	26.04986
5	205	7671	11496	89.77180	28.59986
6	129	7800	12270	91.28145	30.52543
7	116	7916	13082	92.63897	32.54553
8	71	7987	13650	93.46987	33.95860
9	69	8056	14271	94.27736	35.50353
10	52	8108	14791	94.88590	36.79719
11	44	8152	15275	95.40082	38.00129
12	29	8181	15623	95.74020	38.86705
13	30	8211	16013	96.09128	39.83730
14	22	8233	16321	96.34874	40.60354
15	27	8260	16726	96.66472	41.61111
16	15	8275	16966	96.84026	42.20818
17	17	8292	17255	97.03920	42.92716
18	11	8303	17453	97.16793	43.41974
19	14	8317	17719	97.33177	44.08150
20	12	8329	17959	97.47221	44.67857
21	5	8334	18064	97.53072	44.93980
22	11	8345	18306	97.65945	45.54184
23	5	8350	18421	97.71796	45.82794
24	5	8355	18541	97.77648	46.12648
25	6	8361	18691	97.84669	46.49965
26	8	8369	18899	97.94032	47.01712
27	6	8375	19061	98.01053	47.42014
28	8	8383	19285	98.10415	47.97741
29	6	8389	19459	98.17437	48.41029

Të dhëna statistikore për veprën e Fatos Arapit sipas programit SCP



deti, eja, era, fshat, gjallë, gjitha, gruas, harruar, hop, itali, italianët, keq, kishën, la, mbrëmë, piloja, pëshpëriti, sheh, trup, ushtarin, (12x), bëhej, dafinë, dëgjuar, egër, Evropi, fundit, italianë, kujtua, kuptoi, kurse, lëshoi, ndal, ndiente, niko, njeriut, qante, sakaq, shkonte, shkuar, shtrirë, tre, ugo, varr, vendit, vjen, vërtet, zuri (13x), binte, doli, eh, frikë, fytyrë, hapur, hyri, keni, luftë, mëdhenj, perëndi, qoftë, shikonte, sëmure, thashë, tjerë, tutje, udhë, ushtarë, zgjati, zotit (14x), apo, askush, bar, derisa, djali, errësirë, gati, italianin, krahët, lë, mbuluar, mend, mezi, mu, ndreu, nisën, oficerit, papritur, prapa, rënë, sapo, shtëpisë,, sërish, ushtar (15x), asnjë, jetë, kohë, kuptonte, lehtë, madhe, moj, ndonjë, ndoshta, rreth, vrarë (16x), bënte, disa, dua, hapi, huaj, kryeplakut, këndeje, mbante, shi, shikimin, toka, ushtarëve, vend, vesh, çdo, zot, (17x), afrua, asgjë, bardhë, dëgjoi, dëgjonte, fshatari, gjithnjë, njerëz, oficerin, përgjigj, tjerët (18x),


*Dino, fliste, foli, fshatarët, grua, italia, kaq, mendoj, menduar, nazistët, tonë, u ul (19x),
 duhej, ecte, fjalë, ftohtë, jemi, madh, marrë, more, murmuriti, sot, ushtarit, (20x),
 kanë, këto, shtëpi, thua, thënë (21x),
 aq, bëri, copë, kokën, këta, lart, mi, partizani, rëndë, shihte, ty (22x),
 ardhur, jashtë, ngadalë, një, vdekur (23x),
 dha, fshatit, fund, hodhi, mes (24x),
 ca, duar, gjë, kemi, kishës (25x),
 bërë, erdhi, kjo, kurrë, ngriti, njeri, roveli, vinte (26x),
 bë, ja, mori, thirri, tokë, çfarë (27x),
 atëherë, heshtur, italiani, kishë, ngrit, njeriu, përse, ri (28x),
 dorën, duart, janë, midis, pak, qe (29x),
 dikush, duhet, luixhi, partizanët (30x),
 atyre, kokë, kthye, këmbët, re, ugoja, ushtarët (31x),
 detit, kryeplaku, pietroja, saj (32x),
 ditë, diçka, jam, lapi, thellë, ve (33x),
 donte, gjatë, gruaja, je, veten (34x),
 dorë, kush, këmishëziu, kështu, officer (35x),
 brenda, deri, këtë (38x),
 barba, mihali, prapë, qenë (44x),
 ato, ju, zoti (62x),
 ashtu, dafina (77x),
 sytë (90x),
 i 1108x
 të 1908x
 e 2339x*

Nga denduria e përdorimit të fjalëve në prozë bie në sy përdorimi i ndajfoljeve *këtu, atje, brenda, andej*; përemrave *ne, ata, ato*, me folje: *thoshte, ecte, u afrua*, pjesëzat *po, mos, nuk* karakteristikë e ligjëritimit në prozë, pasi me anë të tyre autori ndërton kohën dhe vendin, ngjarjen dhe rrëfimtarin;

Të dhëna statistikore për veprën e Fatos Arapit sipas programit SCP

Ja dhe të dhënat e të dy veprave në një tabelë të përbashkët, mbi bazën e të cilave kemi ndërtuar edhe grafikët përkatës.

	Eklipsi i ëndrrës	Deti në mes
Njësi leksikore	4454	8545
Raste përdorimi	16997	40196
DMP	3.8 %	4,7 %
Kn.	2.53 %	3.1 %
Gr. 1	84.95 %	83.8 %
Gr. 2	7.9 %	8.8 %
Gr. 3	7.1 %	6.1 %
Me 1 rast përdorimi	63.85 %	65.23



Në fjalë me denduri të ulët përdorimi cikli poetik "Eklipsi i ëndrrës", del me një numër më të madh fjalësh. Afro 1% më shumë e njëjësive leksikore të veprës përsëriten dy ose tri herë. Duket se autori është i

kujdesshëm në përzgjedhjen e fjalëve, nuk dëshiron të bie në përsëritje të fjalëve.

Kjo përqindje ulët në fjalët me denduri mesatare. “Te deti në mes” kemi rreth 1% e fjalëve të përdorura mbi 3 herë, kjo lidhet me përshkrimin e vendeve, ngjarjeve dhe personazheve.

Në këtë vepër gjejmë fjalë më denduri të lartë përdorimi si: *Atdhe, dashuri, dritë, jetë, liri, nënë, sy, tiranë, tokë, trishtim, ëndrr, tragjedi, Evropë, fat, gjak, dhembje, diell, lot, qiell, shpirt, varr, zemër, zot ...* etj, të cilat janë dhe fjalë çelës në këtë vepër.

Te “Deti në mes”, fjalët më denduri të lartë përdorimi dalin kryesisht emrat e personazheve: *Pietroja, Barba, Mihali, Dafina, Piloja, pjesë të trupit të njeriut si: trup, kokë, këmbët, krahë, fytyrë, sy ...* etj, që lidhen me përshkrimin e personazheve. Gjejmë edhe një grup të përbashkët fjalësh si: *tokë, jetë, Evropë, det, varr, sy, zot, frikë, shpirt ...* etj.

Te “Deti në mes” me 13x përdorim dalin 30 fjalë dhe me 20x herë përdorim dalin 12 fjalë, kurse te “Eklipsi i ëndrrës” me 13x përdorim kemi 16 fjalë, me 20x përdorim kemi vetëm 4 fjalë.

Parë në vështrim krahasues, denduria e përdorimit në nivelin e ulët nga 1– 6x, del se vepra në tërësi, është më e ulët se në prozë dhe më e lartë se në poezi. Kjo duket edhe në grupin e dytë, atë të me frekuencë të mesme përdorimi.

II. Frekuenca e grafemave në “Eklipsi i ëndrrës” dhe “Deti në mes”


Meqenëse programi njeh vetëm 25 shkronja, kemi qenë të detyruar t’i përshtatemi programit, i cili *r* dhe *rr* i merr si një shkronjë të vetme; *gj*-në e merr si *g* dhe *j*, *sh*-në si *s* dhe *h*. Ç-në dhe ë-në i lexon si simbole, kështu marrim nga programi 27 shkronja (grafema)

E themi këtë për ta pasur më të qartë leximin e tabelës.

Nga tabela e ndërtuar për frekuencën e tingujve (grafemave), kemi te: “Eklipsi i ëndrrës” 28546 zanore ose 39.7% ; te “Deti në mes” kemi 73038 zanore ose 44.3 % e tyre, pra te “Deti në mes” kemi një frekuencë më të lartë të tingujve (grafemave) zanorë se bashkëtingëllorë.

Për të krijuar një ide edhe më të qartë rreth krahasimit të frekuencës së tingujve (grafemave në të dy veprat) le të shohim grafikun.

Të dhëna statistikore për veprën e Fatos Arapit sipas programit SCP




III. Frekuencat me gjatësinë e fjalëve në “Eklipsi i ëndrrës” dhe “Deti në mes”

Gjatësia e fjalëve është vjelë nga ... *plain* në të cilën fjalët janë në trajtën e përdorimit dhe jo në trajtën e fjalorit, kështu që përputhja për disa fjalë mund të mos jetë e saktë, por ne e shohim fjalën në ligjërime (të shkruar), të gjallë, ku fjala vjen jo vetëm me trajtëforma të larmishme, por edhe semantikisht e ngarkuar me ngjyime të shumta. Markimin e fjalës do ta shohim më mirë duke e dhënë fjalën në struktura të thjeshta.

Duke qenë se qëllimi ynë në këtë punim nuk është ana drejtshkrimore e fjalëve, por gjatësia e tyre, ne kemi menduar t'i lëmë fjalët ashtu si janë vjelë, për t'u përqendruar vetëm te gjatësia e tyre. Gjithashtu duhet të kemi të qartë se te gjatësia e fjalëve e cila nuk përputhet më shqipen e cila përmban edhe 9 shkronjat dyshe, ne i kemi kryer statistikën sipas programit SCP, i cili e numëron fjalën germë për germë.

Tabela, dhe grafiku dhe fjalët e përzgjedhura kanë për qëllim të tregojnë kujdesin që autori tregon në zgjedhjen e fjalëve. Parë në këndvështrimin e gjatësisë së fjalës vihet re se autori zgjedh kryesisht fjalë të gjata.

Shkronja	Sasia e fjalëve sipas veprave	
	EKLIPSI	DETI
<5	741	1927
5	762	1455
6	839	1593
7	749	1362
8	521	965
9	380	605
10	226	341
11	130	182
12	61	72
13	17	22
14	16	13
15	4	3
16	2	-



Për ilustrim po japim disa nga fjalët e përdorura, të grupuara sipas gjatësisë së fjalëve.

Eklipsi i ëndrrës

afërditë, akeronti, albulenë, antigona, arbëresh, bojëdeti, bukurezë, burimeve, buzëqesh, dashuria, diellore, engjëlli, epitafet, errësirë, fluturoj, fshehtas, gjakosur, harrimit, ishullit, këpuckat, legjendë, ligjshme, livadhiti, llahtarë, mermertë, mesdheut, mirazhet, murmurin, mustakut, mëkatarë, mëngjesi, narciztë, njerëzor, pafajësi, peizazhe, pelikani, pellazge, pickimin, pikëllim, pishtarë, pjellore, popullor, pranverë, prometej, puplajën, pëllumba, qiellore, qiparizi, rilindur, sfilitur, shashicë, shekulli, shkrepje, shpatuke, shpirtra, shpresat, shqiptar, stërkala, thinjari, thërmizë, thërmola, tiranase, tragjedi, trishtim, ullinjë, urretje, varrezës, varrosën, vdekjeve, vdekurit, vlonjate, ëndrrave, xhelatët, zambakut, zemrekut, zeshkane, zodiakun (8 shkronja)

akullonte, bardhësie, barrikadë, braktisur, breshkore, bubullima, dritësuar, fantastik, fantazmat, fildishtë, fërgëllon, hidhëruar, hijerëndë, hipokrite, kameleonë, kristalor, kristaltë, kryqëzova, kthjellët, kurrizore, kurrkushi, llogoraja, mjegullor, pafajësi, pagjumësi, papërlyer, parathotë, pavdekësi, perëndimi, popullor, portokall, përjetësi, rozmarinë, shekullit, zvernecit (9 shkronja)

aeroportet, angullimën, ballkanike, buzëngjyer, dinjitetit, fatetemrat, gjysëmfiati, hipokrizia, kaltërsive, kristalore, kryeatdheu, luleulliri, mbretërore, ministore, mjegullave, ngushëllim, nëndheshëm, pavdekshëm, shpirtmaji, skënderbeu, trëndafilë (10 shkronja)

aeroporteve, aleksandria, apokaliptik, arkitekturë, dhemshuruar, dinakërisht, gjelbëroshe, gjysmëndrre, inkuizitori, jonjerëzore, katakombeve, këngaadheu, madhërishëm, madhështore, ndershmëria, ndërgjegjen, paravdekjen, pikëtakimet, prapaskenat, përdëlluese, përmallshëm, skandalisht, sypicigjate, turfullonin, udhëkryqeve, vetëflijuar, zhgënjimesh, zhubravitur (11 shkronja)

apokaliptike, buzëmbremjes, dallëndyshja, duarbuavitur, gjysmëgjallë, gjysmëvdekur, gjysëmbrenge, gjysëmputhje, luleshtrydhe, mbinjerëzore, shkrepëtitës, shkujdesshëm, shungulluese, supermoderne, xixëllonjash (12 shkronja)

bashkëkohësit, bashkëshortor, dallëndysheve, dhjetëlekëshe, drithëronjëse, gjysëmëmshirë, gjysëmëndërre, inkandeshente, krematoriumet, këngëgjëmimin, kërcëllueshëm, ndërkombëtare (13 shkronja)

intelektualësh, krematoriumeve, mikroorganizma, pamëshirueshme, papërsëritshëm, rezetgishtrinj, vejushadënesje (14 shkronja)
gjysmëfantazmat, gjysmëperënditë (15 shkronja)
gishtërinjvdekja, shpirtishqiponjë (16 shkronja)

Deti në mes

Adriatikut, aerodromit, aeroplanit, Aleksandra, amerikanët, analfabetë, artilerinë, autoblanda, baltovinës, batalionit, befasishëm, belbëzonte, bersalieri, breshërimë, buzëqeshje, dashamirës, drashovica, engjëllore, flakëronte, frymëzuese, fshehurake, gojëkyçura, gojëçorape, gjysmëhapët, këmishëziu gjysmëterr, ikonostasi, imperatori, intendent, kapistalli, kallogresë, kodërdetin, kokëmadhit, kryeplakut, këmishëziu, leckamanët, lemerishme, leshverdhë, matrapazët, medalionin, mjegullinë, ngjethshëm, pulëbardhë, shtatlartë, verdhëmavi, (10 shkronja)
breglumasit, buzëdredhur, buzëtrashit, grykëpishës, komimistëve, llapashitur, gjysmëterri, gojëkyçura, grykëpishës, kryezbuluar, kundërajror, kundërmonte, kënetishtës, llapashitur, madhështinë, madhështore, mallëngjyer, mëshirëmadh, mjekërejapi, ndjellazezë, ndërgjegjen, ndërlidhjen, neveritshme, njëthundrak, partizanësh, pijeshitësi, poteremadhe, përgjakshme, përgjëruese, ndjellazezë, projektorit, proklamaten, regjimentit, shkumëzuese, shëndriadha, zbrazëtirës (11 shkronja)
fytyrëzbehtë, gjysmëranore, kallamishte, kamiçianera, karabinierët, marramenthin, mospërfillës, pijeshitësin, plotfuqishëm, postëkomandë, përshkënditi, shpërfillëse, shungullonte, shëmbëllente, surratpatate, zhuzhuritnin, zverdhëlleme (12 shkronja)
atypëratyshëm, bythëgrisurit, instiktivisht, kallamishteje, kundërgoditje (13 shkronja)
fytyrërreshkur, grumbujgrumbuj, kapërtheheshin, llapashiteshin, ngatërroheshin, paralajmëronte, porsashtrydhur, përshkruheshin, shpërfytyruara, shëmbëlltyrash, vrundujvrunduj (14 shkronja)

Konkluzione

Në veprën e shfrytëzuar për studim nga Fatos Arapi me anë të programit SCP Statistik, kemi nxjerrë se janë përdorur 32000 njësi leksikore, të cilat dalin në 276307 raste përdorimi. Në bazë të përlllogaritjes del një denduri mesatare përdorimi (DMP) për njësi leksikore prej 8.6 herësh, dhe kufiri më i ulët ndarës është 5.8.

Në fjalë me denduri të ulët përdorimi 1– 6 herë, del me një numër më të madh fjalësh, 27813 njësi leksikore, ose 86.91% e leksikut të veprës. Duket se autori është i kujdesshëm në përzgjedhjen e fjalëve dhe nuk dëshiron të bjerë në përsëritje.

Kjo përqindje ulet në fjalët me denduri mesatare 7-13 herë, ku dalin 1969 njësi leksikore, ose 6.1% e leksikut; kjo lidhet me nevojën për të theksuar tematikën dhe idetë e veta, me përshkrimin e vendeve, ngjarjeve dhe personazheve, autori përzgjedh fjalë me denduri më të lartë.

Fjalë me denduri të lartë përdorimi dalin 2218 njësi leksikore, ose 6.9% e leksikut. Shumë nga këto leksema janë *fjalë-çelës*, *figura-çelës* apo edhe *tema-çelës*. Këto leksema i gjejmë jo vetëm në një vepër, as vetëm në prozën e Fatos Arapit, por në gjithë krijimtarinë e tij, si në prozë edhe në poezi, pra jo vetëm në rrafshin e tekstit, por edhe të metatekstit, me anë të të cilave organizohet i gjithë produkti letrar te Fatos Arapi. Shumë prej këtyre leksemave kanë fituar vlerën e simbolit, duke e zgjeruar aftësinë e tyre shenjuese dhe ndikojnë në sistemin e figurshmërisë.

Fjalë të tilla janë: *atdhe*, *zot*, *njeri*, *nënë*, *tokë*, *det*, *fjalë*, *ëndërr*, *Evropë*, *diell*, *qiell*, *shekull*, *sy*, *këngë*, *zemër*, *dashuri*, *dritë*, *jetë*, *vdekje*, *gjak*, *trup*, *vetmi*, *ftohtë*, *varr*, *grusht*, *hije*, *humbur (i)*, *udhë*, *fat*, *kommunizëm*, *kokë*, *ndezur*, *punëtor*, *shoh*, *buzë*, *ditë*, *emër*, *gjelbër (i)*, *mal*, *burrë*, *popull*, *dorë* ... etj.

Të dhënat statistikore të nxjerra prej veprës së Fatos Arapit do të mund të shërbejnë edhe për studime të tjera, si për veprën e Fatos Arapit e cila është mjaft e pasur me lëndë gjuhësore ashtu edhe për studime përfaqësuese për gjuhën e autorëve të ndryshëm, parë nga interesa dhe këndvështrime të ndryshme gjuhësore.

